

Nr. 21 Prot.  
Dt. 31/10/2018

**Marrëveshje Bashkëpunimit (Memorandum)**

e datës 31/10/2018

**PALE:**

- (1) **European Education Initiative sh.p.k.**, shoqëria zotëruese e institucionit te arsimit te larte "**Universiteti European i Tiranës**", me seli ne adresën: Bulevardi Gjergj Fishta, ish-NPV 2, Tiranë, Shqipëri, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS K62029010L, përfaqësuar nga administratori Z. Arbi Agalliu dhe Presidenti i UET Prof. Dr. Adrian Civici në cilësinë e personit përgjegjës për partneritetet strategjike dhe në përfaqësim te organeve akademike te UET, (me poshtë quajtura **UET**)

**dhe**

- (2) **Balfin Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Rrugë "Papa Gjon Pali II", Ndërtesa Nr.12, Kati 11-të, Zyra nr.1206, Njësia bashkiake nr.2, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: K72223031K, përfaqësuar nga administratori Znj. Edlira Muka, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, (me poshtë quajtura **BALFIN**).

**TE PERGJITHSHME**

- (A) UET është një institucion i arsimit të lartë, i licensuar në përputhje me ligjin shqiptar me licencë nr. 639, datë 20.09.2006 dhënë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës;
- (B) BALFIN është shoqëria kontrolluese e një grupei shoqërish te angazhuara ne sektor te ndryshëm tregtar si retail-it, import-eksportit, prodhimit, ndërtimit, ..... etj., (ne vijim quajtur "BALFIN GROUP");
- (C) Ky Memorandum vendos termat dhe kushtet kryesore të cilat shërbejnë për të dy palët për të ngritur bashkëpunimin me synimin e forcimit të lidhjes industri-universitet, në funksion dhe interes afatgjatë e strategjik të të dy palëve;
- (D) Ky Memorandum mbështetet në dëshirën e plotë të palëve për bashkëpunim, ai nuk është detyrues, nuk nënshkruehet para palëve të treta dhe humbet fuqinë e veprimit të tij me vullnetin e shprehur të secilës palë.



## 1. ÇËSHTJET KRYESORE

1.1 Ky Memorandum vendos parimet bazë përmes të cilave UET dhe BALFIN hyjnë në një bashkëpunim të dobishëm duke reflektoar dakordësinë për të ndërvepruar mes tyre në mënyrë afatgjate.

1.2 Gjatë kohës së veprimit të këtij Memorandumi, palët bien dakord të bashkëpunojnë mes tyre në lidhje me:


- A. BALFIN dhe/ose shoqëri anetare te Balfin Group do të ofrojë mundësi për internship për studentët e UET-së (në funksion të nevojave të BALFIN GROUP dhe të degëve të studimit që ofron UET). Studentët do mund të zhvillojnë internshipe me një shtrirje kohore nga 3 muaj deri në 6 (gjashtë) muaj);
  - I. Përzgjedha e studentëve për internship do të bëhet në fazën e parë nga UET
  - II. Më pas kompania BALFIN GROUP perzgjedh studentet fitues per intership ne baze te politikes se brendeshme te shoqerisë/ve në lidhje me këtë sherbim.
  - III. Për studentët që do të kryejnë internship në BALFIN GROUP, ai (BALFIN GROUP) mund vlerësojë në fund të periudhës performancën e studentëve gjatë internshipit.
  - IV. Numri i studentëve që do të kryejnë internshipin në BALFIN GROUP, koha dhe fusha e specialitetit do të dakordësohet mes palëve në funksion të nevojave të BALFIN GROUP, aksesit në orare të përshtashme të studentëve, si dhe kufizimeve ligjore të cilat duhet të merren në cdo rast në konsideratë dhe dakordësuar mes palëve.
- B. Palët bien dakord për të vendosur një bashkëpunim në terma të organizimit të leksioneve të hapura, prezantimeve në ambjentet respektive, të vizitave në ambjentet e BALFIN GROUP nga studentët, të prezencës së stafit të BALFIN GROUP në evenete,ëorkshop-e, konferanca, etj të organizuara nga UET dhe që kanë interes për BALFIN GROUP.
  - I. Universiteti do t'i bëjë të njohur, që në fillim të vitit akademik, kalendarin e eveneteve që do të organizojë gjatë vitit, për të gjithë periudhën në të cilën ky Memorandum është në fuqi, me qëllim që BALFIN të përzgjedhë hapësirën e tij të interesit.



C. Palët bien dakord për bashkëpunime që synojnë në:

- I. Përmirësimin e kurrikulave ekzistuese, përshtatjen e silabuseve në pjesë të caktuara, vecanërisisht në pjesën aplikative; hartimin e programeve të reja në nivelin bachelor dhe vecanërisht në master, ndryshimet e propozuara në cdo rast duhet të jenë në përputhje dhe respekt të ligjit të Arsimit të Lartë dhe rregulloreve të brendshme të UET-së.
- II. Bazuar ne kalendarin akademik të UET dhe në mundesite e tij, stafi i BALFIN GROUP mund te angazhohet në leksione të hapura, seminare, atelie profesionale pranë UET-së.
- III. Me paraqitjen e kerkeses prane UET-s nga BALFIN GROUP studentët e masterit mund te angazhohen në punimin e temave të diplomës në fusha dhe çështje me interes për BALFIN GROUP. Temat e punimit do të paraqiten prane UET-s nga BALFIN GROUP, do të miratohen me departamentet respektive dhe do të zgjidhen nga studentët duke u dakordësuar me mentorët. Angazhimi në këtë proces i dy mentorëve, një nga UET për anën teorike dhe të metodologjisë dhe mentor i tjeter, nga BALFIN GROUP për pjesën empirike.
- IV. Ne rastet kur nga Balfin group kerkohet angazhimi i doktorandëve në punimeve doktorale në fusha dhe çështje me interes për BALFIN GROUP, dhe që përputhen me projektet kërkimore të miratuarë në UET, doktorandëve do t'u lehtesohet realizimi i pjesës empirike nga BALFIN GROUP.
- V. Me kerkese dhe në funksion të nevojave të BALFIN GROUP, UET angazhon pedagogët te UET-së për konsulencia dhe trajnime në fushat ku UET ka eksperти. .
- VI. Për punonjësit e BALFIN dhe familjarë të tyre, UET angazhohet të ndjekë një politikë preferenciale të tarifave të studimit e cila duhet të t'i bashkengjitet si aneks kesaj marreveshjeje.

D. Palët bien dakord të bashkëpunojnë në fusha të interesit të përbashkët:

Four handwritten signatures in blue ink, likely belonging to the parties involved in the agreement. The signatures are fluid and individualistic, with the number '3' written below the second signature from the left.

- I. Aplikimin për projekte europiane dhe ndërkontaktore, përmes zyrave të projekteve të se cilës palë si dhe përmes angazhimit të partnerëve lokalë dhe ndërkontaktore të se cilës palë,
  - II. Nënkontraktimin e BALFIN GROUP në projekte akademike dhe të kërkimit të cilat kërkojnë kompetencat dhe ekspertizën e BALFIN GROUP
- E. Palët bien dakord të bashkëpunojnë mes tyre dhe në projekte të përgjegjësi sociale, duke rritur në këtë mënyrë impaktin në shoqërinë shqiptare e më gjërë. Për këtë:
- I. Palët dakordësojnë që zyrat/drejtoret e marrëdhënieve me publikun të paraqesin projektet vjetore, të Institutit Pashko dhe të Fondacionit për Liri Ekonomike dhe mbi këtë bazë të diskutojnë mundësitet e bashkëpunimit, të lobimit dhe të përfshirjes dhe të tretëve.


## 2. KOHEZGJATJA DHE PERFUNDIMI MEMORANDUMIT

- 2.1 Ky Memorandum hyn në fuqi në datën e firmosjes nga të dy palët dhe vazhdon për një periudhë të paktën 1 vjeçare, me të drejtën e rishikimit në fund të mbylljes së çdo viti. Nëse palët nuk shprehen për mosvazhdimin e këtij memorandum atëherë ky Memorandum do të rinovalohet në heshtje me të njëjtat kushte.
- 2.2 Palët mund ta zgjidhin ketë Memorandum edhe në mënyrë të njëanshme, me anë të një njoftimi me shkrim ndaj palës tjetër në çdo kohë. Angazhimet që palët kanë marrë përpara zgjidhjes së Memorandumit do të respektohen deri në fund sikur Memorandumi të mos ishte zgjidhur kurrë.
- 2.3 Çdo marrëveshje që do të arrihet mes palëve në përputhje me këtë Memorandum dhe do të parashikoj kushte detyruese për palët do të rregullohet me një akt të posaçëm i cili duhet të nënshkruhet nga të dyja palët.
- 2.3.1 Palët bien dakord të përcaktojnë një person përgjegjës për të ndjekur gjithë bashkëpunimin mes palëve

(a) Anjeza Kelmendi – Per Pjesen e BNJ

E-mail: a.kelmendi@balfin.al

Cel: 069 20 800 66



(b) Eris Kasmi – Per PR e CSR

E-mail: e.kasmi@ balfin.al

Cel: 069 8092002

(c) Prof. Dr. Ermira Qosja

E-mail: ermira.qosja @uet.edu.al

Cel: 068 20 55 431, 069 2077 020

- 2.4 Gjithshka e shkruar në këtë Memorandum nuk synon ose nuk do të dëmtojë asnjë partnership tjeter të secilës palë.
- 2.5 Ky Memorandum, dhe gjithshka që rrjedh prej tij do të menaxhohet dhe ngrihet në përputhje me ligjin shqiptar, cdo mosmarrëveshje e cila nuk zgjidhet me mirëkuptim mes palëve do të zgjidhet në Gjykatën e Rrethit Tiranë

Për sa më lart, seila palë konfirmon dakordësinë me termat e këtij Memorandumi.

**Universiteti European i Tiranës**

Presidenti

Prof. Dr. Adrian Civici

**European Education Initiative sh.p.k.,**

Administrator

Z. Arbi Agalliu



**BALFIN Shpk**

Administrator

Znj. Edlira Muka

